

## BASHKIA LEZHË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2020

Date

### Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Date 05.05.2020

Për: Bashkimi i Operatoreve “Alba Light” shpk & “2 T” Shpk, me adrese Rruga “Teodor Keko”, godina “Pelivani”, kati 1, Yzberisht, Kashar, Tirane.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Hapur /Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-51344-02-24-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**NDRIÇIMI I QYTETIT ME SISTEMIN LED**”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “I T E. GRUP” shpk, me NUIS K11323001H, me ofertë ekonomike 24,798,000 (njëzet e kater milion e shtatëqind e nentëdhjetë e tetëmijë) lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALBA LIGHT” shpk me NUIS L41307038I dhe shoqëria “2T” me NUIS K01731001M, me ofertë ekonomike 31,615,000 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “RAFIN COMPANY” shpk, me NUIS L52125110A dhe shoqëria “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me NUIS J63229466K, me ofertë ekonomike 28,678,000 (njëzet e tete milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tete mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “I T E. GRUP” shpk, me NUIS K11323001H, nuk përmbush te gjitha kriteret e vecanta te kualifikimit,

Konkretisht:

- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” është kërkuar “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”. Rezulton se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të energjisë elektrike të maturuara, pasi referuar vërtetimit nr. 724 Protokolli rezulton se shoqëria ka 0 lekë detyrime pa përfshirë faturën e muajit Shkurt 2020. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (3.4.2020) dhe nenit 9 të Kontratës së lidhur mes pajtimtarit jo- familjar dhe OSHEE të mirataur nga ERE ku parashikohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv) si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturua”. **Sa më sipër rezulton se nuk është pasqyruar pagesa e muajit Shkurt, muaj i maturuar.**

- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog të prodhuesit ku të pasqyrohen të gjithë specifikimet teknike të produktit”.

Operatori ekonomik ka dorëzuar katalog të prodhuesit të Philips për produktin Philips BG203 LED 79-4S. Nga shqyrtimi i katalogut për produktin e mësipërm rezulton se:

- a) Nuk përmbush specifikimet teknike në lidhje me teknologjinë e ndricimit të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit ndricim me pllakë fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues, teknologjia e propozuar është e ndryshme nga ndricim me pllaka fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues.
- b) Referuar specifikimeve teknike publikuar në shtojcën 10, limit i luhatjes së tensionit është kërkuar nga 176-264 V ndërkohë që është ofruar nga 220-240 V duke mos plotësuar as minimumin e kërkuar.
- c) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjësit të driverit të ndricuesit ( është kërkuar IP 67).
- d) Nuk jepet informacion mbi llojin e izolacionit (referuar specifikimeve teknike është kërkuar galvanik).
- e) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjës automatike.
- f) Nuk jepet informacion mbi nivelin e kursimit.

- g) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrojtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike ( rrufeja) dhe mbinxehja.
- h) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrojtje nga lidhja e shkurtër.
- Operatori ekonomik ka dorëzuar katalog të prodhuesit të Philips për produktin Philips bg762- led 169. Nga shqyrtimi i katalogut për produktin e mësipërm rezulton se:
- a) Nuk përmbush specifikimet teknike në lidhje me teknologjinë e ndricimit të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit ndricim me pllakë fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues, teknologjia e propozuar është e ndryshme nga ndricim me pllaka fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues.
- b) Referuar specifikimeve teknike publikuar në shtojcën 10, limit i luhatjes së tensionit është kërkuar nga 176-264 V ndërkohë që është ofruar nga 220-240 V duke mos plotësuar as minimumin e kërkuar.
- c) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjësit të driverit të ndricuesit (është kërkuar IP 67).
- d) Nuk jepet informacion mbi llojin e izolacionit (referuar specifikimeve teknike është kërkuar galvanik).
- e) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrojtjes automatike.
- f) Nuk jepet informacion mbi nivelin e kursimit.
- g) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrojtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike (rrufeja) dhe mbinxehja.
- h) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrojtje nga lidhja e shkurtër.
- i) Nuk jepet informacion mbi koeficientin e ngarkesës.
- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Test Raportet e produkteve të lëshuar nga laboratorë të autorizuar/ licencuar në të cilën të vërtetohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për të paktën: Fluksin e dritës së ndricuesit (në lumen), Rrymën e Konsumuar, Fuqinë e konsumuar, Koeficientin e fuqisë, Clirimin e dritës në Lumen për vat, Temperaturën e Ngjyrave TcK, Indeksine të transmetimit të ngjyrave.”*
- Nga verifikimi rezulton se :
- Referuar test raportit të dorëzuar nr R 1276 V2 Philips Ledgine – O- EPRS001 rezulton se:

- a) Temperatura e ngjyrave sipas test raportit është 3000 K nga 4000K të kërkuar duke mos plotësuar minimumin e specifikimeve teknike.
- b) Nuk jepet informacion mbi koeficientin e fuqisë.
- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se:  
*“ Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO perkatesisht:*
- a) Çertifikatë **EN-ISO 9001:2015** mbi “Sistemin e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b) Çertifikatë **BS OHSAS 18001-2007** mbi “Sistemin e menaxhimit te sigurise ne pune” ose **ISO 4500:2018**, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit
- c) **ISO 50001 :2011** mbi “Sistemi i menaxhimit të Energjisë”  
 Nga verifikimi i kryer rezulton se:
- ISO 9001 është lëshuar nga LMS Assesment me nr.certifikate AL204690A. Nga verifikimet e kryera në lmsassments.com rezulton se ISO e mësipërme është e revokuar, pra nuk është e vlefshme në momentin e zhvillimit/ vlerësimit të procedurës.
- ISO 18001 është lëshuar nga LMS Assesment me nr.certifikate AL204690C. Nga verifikimet e kryera në lmsassments.com rezulton se ISO e mësipërme është e revokuar, pra nuk është e vlefshme në momentin e zhvillimit/ vlerësimit të procedurës.
- ISO 5001 është lëshuar nga LMS CERT me nr.certifikate TR81904G. Nga verifikimet e kryera në lmscert.com rezulton se ISO e mësipërme nuk rezulton në database.
- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se:
- 2 Inxhinier elektrik, nga të cilët të paktën njëri të jetë drejtues teknik i shoqërisë në licencë;
  - 8 elektrikistë, ku te paktën 1 te jete i pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe 8 të certifikuar me deshmi te sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose ekuivalente si edhe të trajnuar nga prodhuesi i paisjeve.
  - **1 shoferë**
- Punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik duhet të dorëzojë:
- Kontrate pune
  - Diplome
  - Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik
  - Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit ( në rastet që është kërkuar)
  - Certifikatat e trajnimit nga prodhuesi
  - Listëpagesat për periudhën e kërkuar

- a) Nga verifikimet e kryera rezulton se për asnjë prej punonjësve të deklaruar nuk është dorëzuar certifikatë trajnimi nga prodhuesi sic është kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit.
- b) Është kërkuar disponueshmëria e 8 elektrikistëve nga të cilët 8 elektrikistë me IQT. Nga verifikimi rezulton se nje punonjës, megjithëse në kontrate pune është deklaruar si elektrikist referuar listëpagesës, rezulton i punësuar në pozicionin (magaziner me kodin 4321.01). Sa më sipër operatori ekonomik disponon 7 nga 8 elektrikistë të paisur me IQT.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, Operatori ekonomik **ITE. GRUP, skualifikohet.**

Bashkimi i Operatoreve ekonomikë “**Rafin Company**” shpk & “**2 Z Konstruksion**” shpk, nuk permbush te gjitha kriteret e vecanta te kualifikimit,

Konkretisht:

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rafin Company” shpk & “2Z Konstruksion” shpk është krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit Nr. 436 repertori dhe Nr. 149 koleksioni datë 1.4.2020, ku referuar nenit 3 shoqëria “Rafin Company” shpk ka marrë përsipër 90 % të punimeve/ shërbimeve/ furnizimeve ndërsa shoqëria “2Z Konstruksion” shpk, ka marrë përsipër 10 %.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog të prodhuesit ku të pasqyrohen të gjithë specifikimet teknike të produktit.
- Operatori ekonomik ka dorëzuar katalog të prodhuesit të Luxtella për produktin Luxtella L0102G60R. Nga shqyrtimi i katalogut për produktin e mësipërm rezulton se:
  - a) Nuk përmbush specifikimet teknike në lidhje me teknologjinë e ndricimit të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit ndricim me pllakë fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues, teknologjia e propozuar është e ndryshme nga ndricim me pllaka fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues.
  - b) Referuar specifikimeve teknike publikuar në shtojcën 10, limit i luhatjes së tensionit është kërkuar nga 176-264 V, ndërkohë që është ofruar nga 220-240 V, duke mos plotësuar as minimumin e kërkuar.

- c) Në katalog nuk pasqyrohen specifikimet teknike në lidhje me sipërfaqen e ndricimit nga burimi i dritës.
  - d) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjësit të driverit të ndricuesit (është kërkuar IP 67).
  - e) Nuk jepet informacion mbi llojin e izolacionit (referuar specifikimeve teknike është kërkuar galvanik).
  - f) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjtjes automatike.
  - g) Nuk jepet infromacion mbi nivelin e kursimit.
  - h) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrotjtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike (rrufeja) dhe mbinxehja.
  - i) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrotjtje nga lidhja e shkurtër.
- Operatori ekonomik ka dorëzuar katalog të prodhuesit të Luxtella për produktin Luxtella L01036G80R.

Nga shqyrtimi i katalogut për produktin e mësiëpërm rezulton se:

- a) Nuk përmbush specifikimet teknike në lidhje me teknologjinë e ndricimit të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit ndricim me pllakë fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dritën dhe pa efekt verbues, teknologjia e propozuar është e ndryshme nga ndricim me pllaka fosfori për të përhapur në mënyrë uniforme dirtën dhe pa efekt verbues.
- b) Referuar specifikimeve teknike publikuar në shtojcën 10, limit i luhatjes së tensionit është kërkuar nga 176-264 V, ndërkohë që është ofruar nga 220-240 V duke mos plotësuar as minimumin e kërkuar.
- c) Në katalog nuk pasqyrohen specifikimet teknike në lidhje me sipërfaqen e ndricimit nga burimi i dritës.
- d) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjësit të driverit të ndricuesit (është kërkuar IP 67).
- e) Nuk jepet informacion mbi llojin e izolacionit (referuar specifikimeve teknike është kërkuar galvanik).
- f) Nuk jepet informacion mbi nivelin e mbrotjtjes automatike.
- g) Nuk jepet infromacion mbi nivelin e kursimit.
- h) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrotjtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike ( rrufeja) dhe mbinxehja.

i) Nuk jepet informacion nëse është i paisur me mbrojtje nga lidhja e shkurtër.

- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Test Raportet e produkteve të lëshuar nga laboratorë të autorizuar/ licencuar në të cilën të vërtetohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për të paktën: Fluksin e dritës së ndricuesit (në lumen), Rrymën e Konsumuar, Fuqinë e konsumuar, Koeficientin e fuqisë, Clirimin e dritës në Lumen për vat, Temperaturën e Ngjyrave TcK, Indeksine e transmetimit të ngjyrave.”*

a) Nga verifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit rezulton se testet janë kryer nga laborator i Le Tehnika Slloveni e cila është shoqëria prodhuese e Luxtella. Nga verifikimet e kryera në Slovenia Akrediticija (organi qendror i akreditimit në Slloveni) rezulton se Le Tehnika d.o.o, nuk është laborator i akredituar dhe as i certifikuar/licencuar për kryerjen e testeve laboratorike. Akoma më tej nga shqyrtimi i test raporteve të dorëzuara konsatohet se nuk jepet asnjë informacion për *Fluksin e dritës së ndricuesit (në lumen), Rrymën e Konsumuar, Fuqinë e konsumuar, Koeficientin e fuqisë, Clirimin e dritës në Lumen për vat, Temperaturën e Ngjyrave TcK, Indeksine e transmetimit të ngjyrave të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit.*

b) Është dorëzuar test raport lëshuar nga SIQ, nga shqyrtimi i test raporteve të dorëzuara konsatohet se nuk jepet asnjë informacion për *Fluksin e dritës së ndricuesit (në lumen), Rrymën e Konsumuar, Fuqinë e konsumuar, Koeficientin e fuqisë, Clirimin e dritës në Lumen për vat, Indeksine e transmetimit të ngjyrave të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit.*

Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se:

*2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për numrin e punonjesve, i cili duhet të jetë jo më pak se 11 (njembedhjetë) punonjës, për periudhën Janar 2019- Dhjetor 2019 nga të cilët të paktën:*

- 2 Inxhinier elektrik, nga të cilët të paktën njëri të jetë drejtues teknik i shoqërisë në licencë;
- 8 elektrikistë, ku te pakten 1 te jete i pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo

*publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe 8 të certifikuar me deshmë të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose ekuivalente si edhe të trajnuar nga prodhuesi i paisjeve.*

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “2Z Konstruksion” shpk nuk disponon asnjë punonjës të certifikuar nga prodhuesi i propozuar i paisjeve megjithëse referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 436 repertori dhe Nr. 149 koleksioni datë 1.4.2020, nenit 3, shoqëria ka marrë përsipër 10 % të punimeve, duke rënë ndesh me kriteret e vecanta të kualifikimit dhe nenin 74 pika 3, të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: *“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*
- Asnjë prej punonjësve të deklaruar si elektrikist të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “2 Z konstruksion” shpk nuk janë paisur me deshmë të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose ekuivalente pasi shoqëria AQCERT është e akredituar si organizëm certifikues sistemi menaxhimi në përputhje me S SH ISO/IEC 17021-1:2015 "Vlerësimi i konformitetit-kërkesa për organizmat që kryejnë vlerësimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit” dhe jo si organizëm certifikimi personeli që certifikon personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit- Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli”.
- Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: *“Operatori ekonomik për të gjithë mallrat objekt furnizimi duhet të dorëzojë Autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar. Në rast se autorizimi është dorëzuar nga distributor i autorizuar duhet të shoqërohet me marrëveshjen e partneritetit Prodhues-Distributor, ku të pasqyrohen tagrat dhe kompetencat e distributorit. Autorizimi të jetë i dedikuar për këtë procedure dhe të përfshijë të gjithë të dhënat e kontaktit”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “2 Z Konstruksion” shpk nuk disponon autorizim prodhuesi për paisjet, megjithëse referuar kontratës së bashkëpunimit Nr. 436 repertori dhe nr. 149 koleksioni datë 1.4.2020, nenit 3,



shoqëria ka marrë përsiëpr 10 % të punimeve, duke rënë ndesh me kriteret e vecanta të kualifikimit dhe nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: *“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë **“Rafin Company” shpk & “2 Z Konstruksion” shpk, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ALBA LIGHT” shpk me NUIS L41307038I dhe shoqëria “2T” me NUIS K01731001M, me vlere ofertë 31,615,000 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.04.2020

Ankesa: ka ose jo : Po

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 04.05.2020

(Subjekti Ankimues ka paraqitur pranë AK-se shkresë me objekt “Njoftim tërheqje ankese”, me Nr. 52/32, date 04.05.2020, protokolluar pranë Bashkise Lezhe me Nr. 4833/4, date 05.05.2020 me arsyetimin se: Pas rishqyrtimit dhe kthim-përgjigjes se argumentuar nga ana e AK-se, biem dakort me vlerësimin e kryer nga ana Juaj duke mos vazhduar me ndjekjen e kësaj procedure ne instanca te tjera)

\* \* \*

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**K R Y E T A R I**  
**Pjerin NDREU**